


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE
Furnizim me Tонера për të gjitha Njësit shpenzuese në Komunën
e Gjilanit
GI 651 18 013 121

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

- | | |
|------------------|-----------------------|
| 1. Fadil Xhelili | kryesues i komisionit |
| 2. Destan Maloku | anëtar i komisionit |
| 3. Ahmet Aliu | anëtar i komisionit |

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë në rastin e pranimit të këtij vendimi

Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

Gjilan 11/04/2018

u.d. Jehona Hyseni



Zyrtare Përgjegjëse e Departamentit të Prokurimit

Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL lidhur me nenin 78 paragrafi 1 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës, pas shqyrtimit të kërkesës së shërbyesit civil z.Bali Sahiti i caktuar në detyra punuese: Zyrtar për sport në kuadër të NJKRS për lejinin e pushimit pa pagesë nxjerr:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PUSHIMIT PA PAGESË

- 1. APROVOHET** kërkesa e shërbyesit civil z. Bali Sahiti i caktuar në detyra punuese: Zyrtar për sport dhe të njëjtit i **LEJOHET** pushimi pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve nga data: **01.04.2018** e gjer më datë **30.06.2018**.
- 2. Obligohet** shërbyesi civil që pas skadimit të afatit të pushimit pa pagesë, në punë të paraqitet më datë: **01.07.2018**

A r s y e t i m

Nëpunësi civil z. Bali Sahiti i caktuar në detyra punuese: Zyrtar për sport në kuadër të NJKRS i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesën të datës 03.04.2018 që të njëjtit t'i lejoj pushimin pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve për shkaqe shëndetësore dhe trajtim të mëtejme mjekësor jashtë vendit në Francë.

Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë pas shqyrtimit të kërkesës së shërbyesit civil dhe thënieve të cekura në kërkesë ka rekomanduar Organin e punësimit që t'i lejoj pushimin e kërkuar pa pagesë. Kryetari i Komunës në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës pas shqyrtimit të rekomandimit të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil dhe kërkesën e nëpunësit civil, në mbështetje të nenit 89 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të LSHCK lidhur me nenin 8 parag. 1 nënparag. 1.4 dhe nenin 15 dhe 16 të Rregullores nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese Komisionit komunal për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- NJKRS
- Shërbyesit civil
- Në dosje



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
PAGESËN E FATURËS PËR TRANSMETIMIN E DREJTËPËRDREJTË TË
SEANCËS SË PARË (I) TË KUVENDIT KOMUNAL TË GJILANIT


1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **543,98 €** (pesëqindedyzetetë euro e nëntëdhjetetë cent) në emër të transmetimit të drejtpërdrejtë të seancës së parë (I) të Kuvendit të Komunës nga **“Radio Star”**.
2. Pagesa bëhet mbi bazën e faturës: nr. 101/2017 dt. 22.12.2017
3. Bartja e mjeteve bëhet në xhirollogarinë e “Radio Star” në Gjiçan.
4. Pjesë e këtij vendimi është fatura e cekur si në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë zyrtari/ja financiar/e që menaxhon me disponueshmërinë e mjeteve të zyra e Kryetarit.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- Palës,
- DBF-së,
- Arkivit.




Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
PAGESËN E FATURËS PËR DIZAJN, PRINTIM DHE MONTIM I POP UP –IT

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 150,00 € (njëqindpesëdhjetë euro) në emër të shërbimeve të ofruara nga Studio Grafike Pexi në Gjilan për dizajn, printim dhe montim i Pop up- it.
2. Pagesa bëhet mbi bazën e faturës: nr. 2018/10 dt. 27.02.2018
3. Bartja e mjeteve bëhet në xhirollogarinë e “Studio Grafike Pexi” në Gjilan.
4. Pjesë e këtij vendimi është fatura e cekur si në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë zyrtari/ja financiar/e që menaxhon me disponueshmërinë e mjeteve te zyra e Kryetarit.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- Palës,
- DBF-së,
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Bazuar në **nenin 13**. Të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr: 03/L-040, **nenit 78, paragrafi 1** të Statutit të Komunës së Gjiçanit, lidhur me pagesën e subvencioneve për rastet për personat fizik për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore, mbështetur në Rregulloren komunale për subvencione Nr: 01-016-144327 datë: 30.12.2014, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

-I-

Me këtë Vendim të bëhet pagesa e mjeteve financiare në vlerë totale prej: **4610 €**, me shkronja /katërmijëegjashtqindëdhjetëeuro/ sipas regjistrimit të rekomanduar nga komisioni e të aprovuar nga ana e kryetarit të Komunës nr: _____, datë: _____ 2018v për rastet e ndihmave për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore sipas Rregullore komunale për subvencione nr:01-016-144327, datë:30.12.2014,

-II-


Pagesa e mjeteve sipas këtij vendimi bëhet nga kodi për subvencione i DSHMS-së

-III-

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi financiar i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

-IV-

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës





Kryetari i Komunës:

/ Z. Lutfi Haziri /



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-134652 të datës 02.12.2014 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisioneve komunale të aksionarëve, kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR PAGESËN E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË
FORMUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

1. Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.

1	Xhelal Jetishi	400,00€
2	Muhadin Haziri	400,00€
2	Fadil Gashi	400,00€
	TOTALI	1,200.00€

2. Kompensimi i anëtarëve të komisioneve do të bëhet për punën e kryer në takimet e komisioneve të aksionarëve për muajin Shkurt dhe Mars/2018 për kompanitë PPP“ Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.
3. Kompensimi do të bëhet nga mjetet buxhetore për mallra dhe shërbime - Drejtoria për zhvillim ekonomik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa ekzekutimin e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.




Vendimi i dorëzohet:

- DZHE dhe
- DBF-ja



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-134652 të datës 02.12.2014 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisioneve komunale të aksionarëve, kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR PAGESËN E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË
FORMUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

1. Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A.

1	Avdyl Jerliu	800,00€
2	Sami Azemi	800,00€
2	Mukadeze Rexhepi	800,00€
	TOTALI	2,400.00

2. Kompensimi i anëtarëve të komisionit do të bëhet për punën e kryer në takimet e komisionit të aksionarëve për muajin Dhjetor / 2017 ,Janar,Shkurt dhe Mars/2018 të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A.
3. Kompensimi do të bëhet nga mjetet buxhetore për mallra dhe shërbime - Drejtoria për zhvillim ekonomik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa ekzekutimin e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



Kryetari i Komunës

Latfi Haziri


Vendimi i dorëzohet:

- DZHE dhe
- DBF-ja



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014 si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “Tregu”, Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

VENDIM
PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR ANËTARET E KOMISIONIT
KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NLP "TREGU" SHA NË GJILAN

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare për anëtarët e Komisionit të aksionarëve për muajin **Shkurt dhe Mars / 2018**, të si në vijim:

1	Driton Nuhii	400,00 €
2	Albulena Asllani	400,00 €
2	Fidan Kadriu	400,00 €
	TOTALI	1200.00 €


2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi buxhetor mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomi duke u bartë në xhirollogarinë përkatëse të secilit aksionarë veç e veç.
3. Pjesë e këtij vendimi është vendimi i KK-së 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “TREGU” SHA në Gjiçan dhe procesverbalet për takimet e mbajtura të komisionit të aksionarëve.
4. Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kurse ekzekutimin e tij e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet:

- Anëtarëve
- DZHE-së,
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit,
Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

P Ë R

NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR KOMPENSIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT TË QYTETIT TË GJILANIT 02. 146 DATË 31.01.2018

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 02. Nr. 146 i datës 31.01.2018 për kompensimin e anëtarëve të këshillit drejtues të Teatrit të qytetit në Gjilan.
2. Në pikën 3 të vendimit të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi emri "Shpresa Kurteshi" zëvendësohet me emrin "Qamil Llapashtica".
3. Pjesë e këtij Vendimi është edhe vendimi 02. Nr. 288 i datës 13.03.2018. për ndryshimin e vendimit për konstituimin e këshillit drejtues të Teatrit të qytetit të Gjilanit.
4. Zbatimin e këtij vendimi e bënë zyrtarja financiare që menaxhon me disponueshmerinë e mjeteve të zyrës së Kryetarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit të tij

Vendimi i dorëzohet:



- DBF-së
- anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçilane
Gilan Belediyesi

ZYRA E KRYETARIT

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjiçilanit dhe vendimit nr. 845 të datës 03.10.2017 për caktimin e Komisionit mbikëqyrës për shpërndarjen e druve në institucione shkollore dhe shëndetësore si në Qytet njëshu edhe Fshatra e në zbatim të nenit 11 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M P Ë R

LEJIMIN E KOMPENSIMIT PËR PUNË JASHTË ORARIT

I

Me këtë vendim i Lejohet anëtarëve të Komisionit mbikëqyrës për shpërndarjen e lëndëve djegëse - druve, kompensimi i orëve të punuara jashtë orarit punës me datë: 06,13,20,27.01.2018 dhe 03.02.2018 si në vijim;

1. Ramadan Ajvazi - 40 orë pune.....192 €
2. Nazmi Halili - 40 orë pune.....250.80 €
3. Mursel Zymberi - 40 orë pune.....219.60 €

II.

Llogaritja e orëve për pagesë të punuara jashtë orarit punës është bërë nga DBF në bazë të nenit 21 të Ligjit mbi pagat e shërbyesve civil të Kosovës me rritje prej 50% pasi që komisioni ka punuar ditëve të fundjavës dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i komisionit nga pika I e këtij vendimi.

III.

Pagesa lidhur me orët e punuara jashtë orarit punës duhet bërë nga Kodi Buxhetor Paga dhe mëditje të drejtorive përkatëse .

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Vendimi të i dorëzohet,

- Divizionit të pagave
- Komisionit



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri